

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, - Departamenti i Krimeve të Rënda, përmes kryetarit të trupit gjykues, Agim Ademi, anëtarëve të trupit gjykues gjykatësve Ramiz Azizi dhe Naser Maliqi, me sekretaren juridike Naile Neziri, në lëndën penale kundër të akuzuarve J. M. nga fshati G. Komuna e V., të cilin sipas detyrës zyrtare e mbron avokat M. M., nga Gj., për shkak të dy veprave penale edhe atë lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1. nën par.1.1. lidhur me nenin 31 të KPRK-ës, dhe veprës penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par.1. të KPRK-ës, dhe A. S., nga fshati G. Komuna e V., të cilin sipas detyrës zyrtare e mbron avokat V. I., nga Gj., për shkak të dy veprave penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1. nën par.1.1. lidhur me nenin 31 të KPRK-ës, dhe veprës penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par.1. të KPRK-ës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, - Departamenti për Krimeve të Rënda PP.I. nr. 308/2014, të datës 30.12.2014, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik, më datën 28.10.2016, bie dhe në prezence të palëve publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

1. J. M., nga i ati M., dhe nëna N., e lindur R., i lindur ..., në V., me vendbanim të përhershme në fshati G., Komuna e V., i martuar, baba i një fëmije, i punësuar në biznesin e ... “...” me seli në V., me profesion ..., i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

2. A. S., nga i ati S., dhe nëna E., e lindur S., i lindur ..., në V., me vendbanim të përhershëm në fshatin G., Komuna e V., i martuar, baba i ... fëmijëve, i punësuar në V. – ... në “...”, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

J A N Ë F A J T O R

I.

I akuzuari J. M.

Me datë ... 2014 rreth orës ... h, në fshatin S. e J., në hyrje të rrugës për në fshatin V., i shkakton lëndime të lehta trupore të dëmtuarve I. A. dhe F. Q., në atë mënyrë që për shkak të mosmarrëveshjeve rreth biznesit që kishin pasur dy ditë më parë, i akuzuari ditën kritike me veturën e tipit "...” në të cilën ishte duke e drejtuar i akuzuari A. S., duke parë veturën e të dëmtuarëve I. A. dhe F. Q. me të cilin ishte duke e drejtuar F. Q., e ndalin në mes të rrugës dhe nga vetura e tyre del i akuzuari J., ofrohet tek vetura e të dëmtuarve me ç ‘rast fillimisht ua thyen xhamat e veturës e më pas e godet të dëmtuarin I. A. me grushta në pjesë të ndryshme të trupit deri sa në veturë ndodhe edhe i dëmtuari F. Q., me ç ‘rast një person që ishte në veturë së bashku me të akuzuarin A. S., ka hedhur një sprejë – lotsjellës në veturë dhe si pasojë të dëmtuarit I. A. dhe F. Q. pësojnë lëndime të lehta trupore.

Me çka ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1. nën par.1.1. lidhur me nenin 31 të KPRK-ës.

II.

Me datën, kohën dhe vendin si nën dispozitivin nën I, të aktgjykimit i akuzuari ka dëmtuar dhe bërë të pa përdorshëm pasurin e të dëmtuarit I. A. në atë mënyrë që i then xhamat anësore të veturës së markës "...” me ngjyrë të ... me tabela të regjistrimit ... duke i shkaktoar dëm material në vlerë të papërcaktuar.

Me çka ka kryer veprës penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par.1. të KPRK-ës.

III.

I akuzuari A. S.

Me datë ... 2014 rreth orës ... h, në fshatin S. e J., në hyrje të rrugës për në fshatin V., Komuna e V., ka ndihmuar të akuzuarin J. M., në kryerjen e veprës penale lëndim i lehtë trupor ndaj të dëmtuarve I. A. dhe F. Q., në atë mënyrë që e ka shoqëruar të akuzuarin J. dhe veturën e tij të markës "...”, e ka ndalur veturën në mes të rrugës, duke ia pamundësuar të dëmtuarve që të kalojnë dhe i njëjti e ka pritur të akuzuarin J. deri sa i njëjti i ka kryer veprat penale dhe më pas së bashku me ta është larguar nga vendi i ngjarjes.

Me çka ka kryer veprën penale ndihmë në kryerjen e veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1. nën par.1.1. lidhur me nenin 33 të KPRK-ës.

Andaj, Gjykata në bazë të dispozitave të neneve 7, 17, 21, 41,46, 51, 73, 114 dhe 374 par. 3 të KPRK-ës, dhe neneve 365, 453, të KPPRK-ës.

I G J Y K O N

1. Të akuzuarin J. M., për veprën penale si në dispozitivin nën I. të aktakuzës, me dënim gjobë në lartësi prej 500 (pesëqind) euro të cilën gjobë i akuzuari do ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi në të kundërtën dënimi me gjobë do të i zëvendësohet me dënim burgu llogaritur në 20 euro për një ditë burgimi.

Për veprën penale nën dispozitivin nën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi me dënim të kushtëzuar burgu në kohëzgjatje prej 4.(katër) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet në kohën e verifikimi prej 1.(një) viti nuk kryen vepër tjetër penale në të kundërtën dënimi me kusht do të revokohet.

2. të akuzuarin A. S.

Për veprën penale nën dispozitivin III të aktgjykimit me dënim të kushtëzuar burgu në kohëzgjatje prej 3.(tre) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në kohën e verifikimit prej 1.(një) viti, nuk kryen vepër tjetër penale në të kundërtën dënimi me kusht do të revokohet.

Obligohen të akuzuarit që të i paguajnë paushallin gjyqësor në shumë prej nga 50 (pesëdhjetë) euro secili, si dhe shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të Gjykatës, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Bazuar në nenin 364 pika 1.3. të KPPRK-ës

I akuzuari A. S.

LIROHET NGA AKUZA

Se me datë, kohë dhe vend si në dispozitivin nën I. të aktgjykimit ka dëmtuar dhe ka bërë të pa përdorshëm pasurinë e të dëmtuarit I. A. në atë mënyrë që i thyen xhamat anësor të veturës të markës “...” me ngjyrë të ... me tabela të regjistrimit ... duke i shkakuar dëm material të dëmtuarve në vlerë të pa përcaktuar.

Me çka kishte me kryer veprën penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par.1. të KPRK-ës.

Shpenzimet e procedurës bien në barrë të mjeteve buxhetore të Gjykatës

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan,- Departamenti për Krimeve të Rënda ka paraqitur aktakuzë PP.I. nr. 308/2014, të datës 30.12.2014, kundër të akuzuarve A. G., nga fshati B. Komuna e K., për shkak të dy veprave penale përdorimi i armës apo i mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.1. dhe veprën penale mbajtja në pronësi, kontrollë ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1. të KPRK-ës, J. M. nga fshati G. Komuna e V., dhe A. S., nga fshati G., Komuna e V., për shkak të dy veprave penale në bashkëkryerje veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1. nën par.1.1. lidhur me nenin 31 të KPK-ës, veprës penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 paragrafi 1. lidhur me nenin 31 të KPRK-ës dhe ka kërkuar që të akuzuarit të shpallet fajtorë dhe të dënohet me dënim meritor sipas ligjit.

Gjykata ka bërë veçimin e procedurës sa i përket të akuzuarit A. G., duke qenë se i njëjti në shqyrtimin fillestar e ka pranuar fajësinë dhe sa i përket këtij të akuzuari është nxjerrë aktgjykim PKR. nr. 2/2015 me datë 11.07.2016.

Prokurori i Prokurorisë Themelore në Gjilan, Arben Kadriu fillimisht mbeti në tërësi pranë aktakuzës lidhur me të dy të akuzuarit ndërsa në fjalën përfundimtare deklaroi se: gjatë procedurës paraprake si dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar gjendja faktike dhe fajësia e të akuzuarve J. M. dhe A. S., për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe veprës penale Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë në bashkëkryerje nga neni 333 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së. Se vërtet të akuzuarit kanë kryer veprat penale të cilat vërtetohen me dëshminë e të dëmtuarit- dëshmitarit F. Q. i cili ka deklaruar se vetura e A. it në momentin kritik ia kishte pamundësuar lëvizjen përpara dhe se nga ajo vetura kane dalë ... persona dhe se njëri nga ta ia kishte thyer xhamin veturës. Se vërtet kishte pasur përleshje, mirëpo për shkak të hedhjes së spreit në sy nuk ka mundur të vërejë asgjë. Pas ngjarjes e kishte ftuar me telefon të akuzuarin J. M. dhe e

kishte pyetur se pse ma bëre këtë dhe i njëjti është përgjigjur duke i kërkuar falje se kishte qenë një gabim. Kjo gjendja faktike vërtetohet edhe nga dëshmia dëshmitarit I. A. i cili kishte deklaruar se dy ditë para ngjarjes kritike derisa sa ishin duke punuar në fshatin V. në shtyllat e KEK-ut kishte ardhur i pandehuri J. M. dhe i kishte thënë që të mos punonin më pa ndonjë arsyeje, dhe se në ditën kritike ia kishte zënë rrugën me veturë "...” dhe nga vetura kishte dalë J. M. i cili ia kishte thyer xhamat e veturës ndërsa një person tjetër u kishte hedhur prej në sy. I akuzuari J. M. e kishte goditur me grusht derisa i pandehur A. kishte qëndruar ne veturë. Në bazë të raporteve mjekësore dhe konstatimeve të ekspertit të mjekësisë ligjore vërtetohen deklaratimet e të dëmtuarve se ditën kritike të u janë shkaktuar lëndime trupore të dëmtuarit F. Q. skuqje në regjionin e fytyrës dhe të syve në të dy anët. Lëndime të shkaktuara trupore nga veprimi mekanik i mjetit të fortë mbretës, që si të tilla bëjnë pjesë me dëmtime të lehta trupore dhe të dëmtuarit I. A., skuqje në regjionin e gjoksit, lëndime të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të fortë mbretës. Deklarimin e të dëmtuarve për dëmtimin e pronës mbështetët ne raportin e këqyrjes se vendit të ngjarjes, foto albumin ku vërehet vetura "...” me xhama të thyer, dhe e tëra ka përfunduar kur A. G. ka shtënë me armë në ajër. I propozoj gjykatës që të akuzuarit të shpallen fajtor dhe të dënohen me dënim meritator sipas ligjit, si rrethane renduese të merret parasysh se të pandehurit nuk e kane pranuar fajësinë për veprat penale që ua vene ne barrë akuza, shkallen e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, mënyrën e vrazhde të kryerjes se veprës penale, se të pandehurit kane qene te organizuar, të përgatitur paraprakisht për të kryer veprat penale duke iu dalë në pritë të dëmtuarve.

I dëmtuarit F. Q. deklaroi se: nuk i bashkohem ndjekjes penale ndaj te akuzuarve dhe nuk ushtroi kërkesë pasurore juridike, deri sa në cilësinë e dëshmitarit shtoi se është e vërtetë se ditën kritike unë kam qene se bashku me I. n me veturën e tipit "...” ngjyre te..., të cilën kam qen duke e vozitur dhe papritmas me është thyer xhami i veturës derisa unë isha i ndaluar afër kryqëzimit të fshatrave S. e J. duke dalë në rrugën e fshatit V., deri sa para veturës ka qenë e ndaluar veture e tipit "...” me ngjyrë ..., e cila ka qenë e A. S.t, e që më ka pamundësuar lëvizjen përpara. Nga vetura kanë dalë katër persona dhe njeri prej tyre ma ka thyer xhamin e veturës dhe me ka hedh prej në sy por mund të them se këta dy të akuzuar nuk kanë qenë ngase të njëjtit i njoh edhe më parë. Është e vërtetë se ka pasur përleshje mirëpo për shkak të sprejit që kamë pasur në sy nuk kam mundur të shoh asgjë, unë jam munduar të dal nga vetura dhe posa kam dalë ashtu duke më djegur sytë kam dëgjuar dy krisma të armës. Pas ngjarjes e kam ftuar në telefon J. M. dhe i kam thënë “pse ma bëtë këtë” i njëjti me është përgjigjur “më faj dajë se ka qenë një gabim”. Mirëpo nuk me kujtohet se a e kam thirrur A. in, të cilin e kam takuar edhe në Stacionin Policor dhe me ka kërkuar falje për ngjarjen që ka ndodhur.

I dëmtuarit I. A. deklaroi se: i bashkohem ndjekjes penale ndaj te akuzuarve ndërsa nuk ushtroj kërkesë pasurore juridike, deri sa në cilësi të dëshmitarit shtoi se unë merrem me shpërndarjen e kablllove të internetit edhe atë që 4 vite dhe se është e vërtetë se kemi pasur probleme me firmën “Kom net” pronar i së cilës është A. K. nga fshati P. si dhe Sh. I. nga fshati S. Komuna e V. ndërsa nuk e di se a ka lidhje me këtë J. M. por i

njëjti shoqërohet me ta dhe kam mëndur se edhe ky është pronar i "...". Dy dite para ngjarjes kritike deri sa ishim duke punuar në fshatin V. shtylla të KEK-ut, ka ardhur J. M. dhe na ka thënë mos punoni ma dhe se për çfarë arsye nuk e di. Ditën kritike deri sa kemi qene duke udhëtuar me veturën time "...", ku ishte duke e vozitur F. Q., përpara na kanë zënë rrugën A. i dhe J. sikundër edhe dy persona tjerë njeri nga fshati S. i cili ka qene i gjate, ndërsa personin tjetër nuk e njohë, rrugën na e ka zënë vetura "... " e cila veture ka qenë e A. it dhe i cili ishte duke vozitur. Me rastin kur na kanë zënë rrugën ne kemi menduar se po duan me bisedua me neve, por në atë rast J. ka ardhur dhe e ka thyer xhamin e veturës nga ana e pasagjerit ku isha unë i ulur dhe më ka goditur tre herë me grushte ne pjesë të trupit, derisa xhamin e veturës nga ana e shoferit e ka thyer një person tjetër të cilin nuk e kam njohur dhe me atë rast ka hedhur sprej në veturë, e po ashtu edhe ky person më ka goditur me kembë për xhamin e thyer të veturës dhe e tëra ka përfunduar kur personi me emrin A. G. ka shtënë ne ajër me armë dy herë

Dëshmitari B. A. n fjalën përfundimtare deklaroi se : se në momentin kur ka ndodhur ngjarja kam qenë në sigurimin e maturanteve ne fshatin S., dhe në këtë rast jam kyçur pas 4-5 ditëve pasi që lënda ka ardhur në hetime. Sipas raportit të patrullës, personat e involvuar në rast para dy dite më herët kanë pasur një mosmarrëveshje lidhur me bizneset e tyre, e për më tepër i përmbahem në tërësi raportit policor.

I akuzuari J. M. në mbrojtjen e tij deklaroi se : lidhur me këtë çështje penale une kam dhene dy deklarata një në Polici dhe tjetrën ne Prokurori dhe plotësisht qëndroi pranë këtyre dy deklaratave, në ditën kritike kam qene me A. in ne drejtim te fshatit V. për ti dërguar disa pajisje te internetit, pasi qe nuk kisha veturë A. i me ka shoqëruar me veturën e tij, dhe në hyrje te fshatit V. kemi takuar F. n dhe I. i cili më ka fyer duke me thënë "largohu nga vetura se ta bëjë sikurse herën e kaluar", në ato momente kam vërejtur se I. kishte pasur diçka në duar dhe ne atë moment e kam goditur dritaren e shoferit pra të F. t për tu mbrojtur, dhe me te goditur dritaren jam sjellë nga ana e prapme e veturës dhe kam dalë nga ana e I. t e kam thyer edhe xhamin kah ana e I. t për t'ia humbur përqendrimin në atë mënyrë që të vetëmbrohem. Pasi ia kam thyer xhamin i kam dëgjuar dy krisma të armës duke menduar se ka shtënë I. kam ikur ne drejtim te veturës se A. it dhe jemi nisur. Unë absolut nuk kam pasur asgjë në dorë e nuk kam pasur as sprej në dorë, po ashtu asnjëherë nuk e ka goditur F. e as I. Ka pasur mundësi të ketë pasur edhe persona tjerë porse me mua ka qenë vetëm A. . Takimi ka ndodhur rastësisht dhe pa paralajmërim. Rruga nuk ka qenë e bllokuar nga vetura e A. , ka pasur edhe vetura të tjera dhe A. i nuk ka dalë nga vetura dhe nuk e ka goditur askënd. Nuk kam kurrfarë shpjegimi se nga i kanë marrë lëndimet të dëmtuarit. Me të dëmtuarin F. raportet i kemi normale dhe me të njëjtin përshëndetemi dhe është e vërtet se F. ka tentuar që të na pajtoj me të dëmtuarin I. para ditës kritike, ndërsa pas ditës kritike me të dëmtuarin F. nuk kemi kontaktuar më. Është e vërtetë se pas ngjarjes kritike e kam thirrur F. për ti kërkuar falje por i njëjti pasi që unë i kam kërkuar falje më ka kërcënuar.

I akuzuari A. S. në mbrojtjen e tij deklaroi se : se në ditën kritike unë askujt nuk i kam shkaktuar lëndime trupore e as nuk i kam shkaktuar dëmtime veturës, dhe se ne ditën

kritike unë kam punuar deri në orën ... të mëngjesit ngase kam qenë në ndërrim të natës. Pastaj e kam takuar J. M. i cili kishte pasur në dorë disa pajisje të internetit dhe i njëjti me ka thënë se a mund te me ofrosh me veturë deri ne fshatin V. që t'ia dërgoi disa pajisje të internetit punëtorëve. Derisa kemi qenë rrugës dhe me tu kthyer rrugës për në fshatin S. e J. , vetura e F. ka qenë e ndaluar gjysme ne trotuar e gjysmë ne rrugë, J. më tha ndale veturën i njëjti ka zbritur nga vetura, por J. nuk me ka thënë se ka pas ndonjë problem me ndokënd dhe se çka ka ndodhur më pastaj kur ka shkuar J. te vetura e F. dhe fillimisht e ka thyer xhamin e pasagjerit e më pastaj e ka thyer edhe xhamin e shoferit. Nga vetura "... " me ngjyrë të ... që ishte para meje ka gjuajtur dikush me armë në ajër dhe me atë rast J. ka ardhur në veturën time dhe më ka thënë ec dhe jemi nisur. Në veturën time pos meje dhe J. nuk ka pasur persona tjerë. Unë nuk e kam sulmuar fizikisht askënd. Po ta kisha ditur se J. ka probleme me ndokënd unë fare nuk do ta dërgoja për në fshatin V.. Unë nuk kam zbritur nga vetura, nuk është e vërtetë se kam pasur edhe ndokënd tjetër n veturë, dhe unë nuk e di se nga i kanë marrë lëndimet të dëmtuarit.

Mbrojtësi i të akuzuarit J. M., avokat M. M. në fjalën përfundimtare deklaroi se : *nuk është provuar që mbrojturi im e ka kryer veprën penale nën dispozitivin III të aktakuzës, përkatësisht për veprën penale lëndim i lehtë trupor ngase kjo nuk vërtetohet nga asnjë provë, nga deklarata e te dëmtuarit- dëshmitarit F. Q. ku thuhet se i mbrojturi im e ka goditur xhamin nga pjesa ku ai ka qenë ulur dhe me këtë rast është goditur nga dy persona, këtë pohim te tij nuk e vërteton asnjë dëshmitar tjetër e as i dëmtuari I. . Prandaj ne mungese te provave propozoj qe sa i përket veprës penale nen dispozitivin III i njëjti te lirohet nga akuza. Sa i përket dispozitivit IV i mbrojturi im – akuzuari J. M. ne te gjitha fazat e procedurës e ka pranuar fajësinë, duke pasur parasysh se i dëmtuari nuk iu ka bashkuar ndjekjes penale si dhe raportet mes vete i kanë rregulluar, se i njëjti ka shprehur keqardhje dhe ka qene ne gjendje t'ia kompensoj demin te dëmtuarit, i propozoj gjykatës qe duke i pasur parasysh këto rrethana te njëjtit ti i shqiptohet një dënim me i butë me te cilin do te arrihet efekti i dënimit.*

I akuzuari J. M., në fjalën përfundimtare deklaroi se : *e përkrah në tërësi fjalën përfundimtare te mbrojtësit tim, njëkohësisht shpreh keqardhje për rastin e ndodhur dhe është hera e parë qe kam rënë në ndesh me ligji.*

Mbrojtësi i të akuzuarit A. S., avokat V. I. i në fjalën përfundimtare të dorëzuar në formë të shkruar e të elaboruar në seancën gjyqësorë shtoi: se nuk është provuar akuza e prokurorit te shtetit sa i përket te akuzuarit A. S. për veprën penale lëndim i lehte trupor, pasi që të dëmtuarit F. Q. dhe I. A. nuk kane deklaruar se ky i akuzuar t'iu ketë shkaktuar lëndime trupore, e këtë nuk e kane deklaruar as i bashkakuzuari J. M. e as dëshmitarit B. A. . Sa i përket dispozitivit IV, i mbrojturi im edhe nga deklarata e te akuzuarit tjetër J. por edhe nga të dëmtuarit nuk thuhet që ta ketë kryer këtë vepër penale. Andaj duke e pasur parasysh thëniet e cekura me larte dhe ne mungese te

provave propozoj gjykatës që i akuzuari të lirohet nga përgjegjësia penale pasi që nuk është provuar se i njëjti nuk i ka kryer veprat penale.

I akuzuari A. S., në fjalën përfundimtare deklaroi se: e përkrahi në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtësit tim, i propozoj gjykatës që të me liroj nga akuza, se me pare nuk kam gene i gjykuar, njëkohësisht shpreh keqardhje për rastin që ka ndodhur.

Gjykata analizoi provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës edhe atë : vërtetimin mbi bastisje e datës2014, raporti i shikimit të vendit të ngjarjes e datës2014, foto dokumentacioni, mendimi dhe konstatimi i ekspertit mjeko ligjor lidhur me lëndimet trupore të të dëmtuarve I. A. dhe F. Q. e datës2014.

Pas shtjellimit dhe analizimit të gjitha provave veç e veç dhe të gjithave së bashku si në kuptim të nenit 8 dhe 361 të KPPRK gjykata konstatoi këtë gjendje faktike: në ditën kritike më datë 29.08.2014, derisa i akuzuari J. M. dhe i akuzuari A. S. ishin nisur me veturën e të akuzuarit A. të tipit "...", për në fshatin V., në fshatin S. e J. e në hyrje të rrugës për në fshatin V., me të vërejtur veturën e tipit ".." të të dëmtuarit I. A. të cilën ishte duke e vozitur i dëmtuari F. Q., e për shkak të një mosmarrëveshje para dy ditësh rreth biznesit, e ndalin veturën në mes të rrugës në mënyrë që ti pamundësohej kalimi i veturës së të dëmtuarve, nga vetura del i akuzuari J. M., ofrohet tek vetura e të dëmtuarve, ia thyen xhamat e përparme të veturës nga ana e të dëmtuarit I. (ulësja e pasagjerit) dhe e godet me grushte në pjesë të ndryshme të trupit, derisa një person tjetër i cili ishte në veturë me të akuzuarit ia thyen xhamin nga ana e shoferit dhe me atë rast hedh sprej dhe pas të shtënave me armë zjarri nga ana e A. G. (i cili rastësisht ishte në vendin e ngjarjes), të akuzuarit largohen nga vendi i ngjarjes, dhe si pasojë e goditjeve dhe hedhjes së sprejit të dëmtuarit I. A. dhe F. Q. pësojnë lëndime të lehta trupore.

Me rastin e konstatimit të gjendjes faktike gjykata ia fal besimin provave materiale edhe atë: mendimit dhe konstatimit të ekspertit mjeko ligjor lidhur me natyrën e lëndimeve të pësura nga ana e të dëmtuarve F. Q. dhe I. A., foto dokumentacionit lidhur me dëmin e shkaktuar në veturën e tipit "... " si pasojë e xhamave të thyer nga veprimi i të akuzuarit J. M. dhe atë 10 fotografi. Iu fal besimi edhe deklaratave të të dëmtuarve I. A. dhe F. Q. për faktin se në vend të ngjarjes derisa ishin vozitur me veturën e tipit "...", janë penguar që të vazhdojnë më tutje pasi që në rrugë ishte ndalur vetura e tipit "...", të cilën ishte duke e vozitur A. S. dhe nga ajo veture fillimisht kishte dalë i akuzuari J. M., e më pas edhe një person tjetër dhe për faktin se xhamat e veturës së tyre ishin thyer nga J. M. me që rast edhe e kishte goditur të dëmtuarin I. dhe se personi që e kishte thyer xhamin e veturës së njëjtë nga ana e shoferit dhe me që rast kishte hedhur edhe sprej në veturë. Iu fal besimi edhe dëshmisë së dëshmitari B. A. lidhur me kohën dhe vendin e kryerjes së veprave penale. Pjesërisht iu fal besimi mbrojtjes së të akuzuarve J. M. dhe A. S.t, për faktin se në ditën kritike me veturën e A. it ishin nisur në drejtim të fshatit V. dhe në fshatin S. e J. e kishin ndalur veturën e tyre, por nuk iu fal besimi mbrojtjes së të

akuzuarit J. se ishin ndalur vetëm për të biseduar për ngjarjen e dy ditë më parë, si kundër edhe për faktin se i njëjti nuk e kishte goditur të dëmtuarin I., ngase kjo pjesë e deklaratës së tij bie ndesh me provat tjera edhe atë mendimin dhe konstatimin e ekspertit mjeko lidhor dhe deklaratat e të dëmtuarve. Po ashtu nuk iu fal besimi pjesës së deklaratës së të akuzuarit A. kur pohon se nuk e kishte ditur që i akuzuari J. kishte probleme me të dëmtuarin I. lidhur me biznesin e tyre dhe për faktin se veturën e kishte ndalur kinse J. për të biseduar me I. .

Gjykata e ka liruar të akuzuarin A. S. për veprën penale asgjësim apo dëmtim i pasurisë në bashkëkryerje ngase në asnjë provë të vetme nuk është vërtetuar që i njëjti të ketë kryer këtë veprë penale, nga deklarata e të dëmtuarve F. Q. dhe I. A. vërtetohet që i akuzuari A. nuk është ofruar fare tek vetura e tyre e as që e ka goditur veturën pasi që i njëjti ka qëndruar në veturën e tij. Të njëjtin fakt se i akuzuari A. ka qëndruar tek vetura e tij e pohon edhe i bashkakuzuari J. M.. Andaj në mungesë të provave që i akuzuari e ka kryer veprën penale asgjësim apo dëmtim i pasurisë nga neni 333 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, e ka liruar nga akuza duke u mbështetur në nenin 364 paragrafi 1 pika 1.3 të KPPRK-së.

Me rastin e caktimit të llojit dhe të lartësisë së dënimit Gjykata pati parasysh rrethanat të parapara me nenin 73 të KPRK-ës, dhe si rrethanë lehtësuese gjeti se i akuzuari J. M. e ka pranuar fajësinë për veprën penale asgjësimi apo dëmtim i pasurisë, duke shprehur keqardhje të thellë, pati sjellje të mira në Gjykatë, premtimi i tij se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale dhe se deri më tani është i pa gjykuar. Po ashtu edhe për të akuzuarin A. S. si rrethanë lehtësuese pati parasysh faktin se i njëjti pati sjellje të mira në gjykate, se me të dëmtuarit janë pajtuar, se ka shprehur keqardhje lidhur me rastin e ndodhur. Ndërsa si rrethanë rënduese pati parasysh shkallën e përgjegjësisë penale të kryesve se veprat penale janë kryer me dashje dhe në vend publik si dhe rrezikshmërinë shoqërore. Në prezencë të rrethanave të shumta lehtësuese e si rrethanë veçanërisht lehtësuese pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit J. M. ju është shqiptuar dënim sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se edhe me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit si në kuptim të nenit 41 të KPRK-ës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është i bazuar në nenin 453 të KPPRK-së.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA
PKR.nr. 157/2016 Me datë. 28.10.2016**

Sekretarja juridike,
Naile Neziri

Kryetari i trupit gjykues
Agim Ademi

KËSHILLA JURIDIKE: *Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë Departamenti për Krimeve të Rënda, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të së njëjtës, ankesa dorëzohet në dy ekzemplar përmes kësaj Gjykate.*